



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2020:101163 C. nr. 1049/2020
Datë: 22.03.2024
Numri i dokumentit: 05489268

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, gjyqtari Atdhe Berisha, në çështjen kontestimore sipas padisë së paditësit I.K. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson V.O. avokat nga Prizreni, kund të paditurës "F.C.", me seli në Komuna e Suharekës, të cilën me autorizim e përfaqëson avokati B.B. nga Prishtina, për kompensim të dëmit material, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik, me datë 30.01.2024, morri këtë:

A K T G J Y K I M

Pjesërisht miratohet kërkesëpadia e paditësit I.K. nga Prizreni.

Detyrohet e paditura Kompania "F.C.", me seli në Komuna e Suharekës në emër të dëmit material t'i paguaj paditësit I.K. nga Prizreni, shumën 2.000,00 € me kamatë vjetore prej 8 %, nga data 12.01.2015 deri në përmbushjen e detyrimit, si dhe të paguaj shpenzimet e procedurës në shumën 1974,00 €, të gjitha këto në afatin prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

Pjesa tjetër e kërkesëpadiës, më tepër se pjesa e aprovuar, e deri në lartësi të kërkesës prej 2.446,00 €, refuzohet si kërkesë e pabazuar.

A r s y e t i m

Paditësi në padi si dhe gjatë seancave, përmes të autorizuarit të vet paraqet se me datë 12 Janar 2015 në kilometrin e 34 të autostradës "Ibrahim Rugova", në drejtim të Prizren – Prishtinë, përkatësisht në daljen në Suharekë, ka ndodhur aksident komunikacioni, ashtu që për shkak të mospastrimit të rrugës nga dëbora nga e paditura, si përgjegjëse për mirëmbajtjen e rrugës, automjeti i markës "Renault Laguna", me targa i cili drejtohej nga paditësi I.K. ndeshet me rrethojat e autostradës.

Nga ky aksident shkaktohen dëme të mëdha materiale, në automjetin e paditësit. Shak për këtë aksident është, bora e cila në këtë pjesë nuk ka qenë e pastruar nga pala e paditure e cila ka qenë e detyruar të bëjë pastrimin e rrugës nga bora.

E paditura ka pasur marrëdhënie kontraktuese me Ministrinë e Infrastrukturës për mirëmbajtjen e kësaj pjese të autostradës, fakte të cilin vetë përfaqësuesi i palës së paditur edhe e pohon. Gjithashtu sqaron se nga administrimi i provave veçanërisht nga raporti i ekspertit të vlerësimit të dëmeve në automjet, është vërtetuar se dëmi i shkaktuar në automjetin e aksidentuar në momentin kur është shkaktuar ai aksident ka qenë 2.446,00 €. I propozon gjykatës që të mos i

kushtojë besimin deklaratës së dëshmitarit Sh.K. me arsyetimin se deklarata e tij nuk ka të bëjë me bazën juridike. Në fund bënë precizimin e kërkesëpadisë, duke kërkuar shumën 2.446,00 €, aq sa është përcaktuar në ekspertizë në momentin e aksidentit. I kërkon shpenzimet procedurale në shumën e përgjithshme 1974,00 € dhe atë për përpilimin e padisë shumën 104,00 €, për përfaqësim në seancë për tri seanca në lëndën C. nr. 129/2015 e cila tani është prishur dhe për 9 seanca në lëndën C. nr. 1049/2020 e cila është kthyer në rigjykim, nga 135,00 € për seancë, për ekspertizën e ekspertit vlerësues shumën 100,00 €, për ekspertizën e ekspertit të komunikacionit shumën 150,00 € dhe për taksën për padinë e paraqitur shumën 21,00 €.

E paditura në përgjigje në padi si dhe gjatë seancave përmes përfaqësuesit të vetë, e kundërshton në tersi padinë dhe kërkesëpadinë e palës paditëse. Sqaron se pala e paditur nuk është fajtores për aksidentin e shkaktuar, pasi që pala paditëse gjatë vozitjes, vozitjes nuk i ka përshtatur kushteve dhe rregullave të komunikacionit. Gjithashtu sqaron se në atë pjesë të rrugës në të cilën është shkaktuar aksidenti, rruga ka qenë e qarkullueshme dhe nuk ka pasur probleme me bllokimin e rrugës, gjë që vërehet nga foto dokumentacioni. E pohon se pala e paditur ka qenë e kontraktuar për të mirëmbajtur atë pjesë të autostradës.

E kanë kundërshtuar edhe konstatimin e raportit të aksidentit me arsyetimin se ai është i mangët. Në të vetëm konstatohet se dyshohet që aksidenti është shkaktuar nga mospastrimi i borës nga rruga. Nuk paraqet asnjë gjurmë të frenimit, nuk përcakton gjendjen e vozitësit nëse ai ka qenë në gjendje të dehure dhe shpejtësinë e lëvizjes. Gjithashtu nuk ka ndonjë skicë të paraqitur nga dalja në vend e policisë dhe përpilimi i raportit.

Ka kundërshtuar ekspertizën e ekspertit të komunikacionit me pretendimin që eksperti nuk e din kohën e saktë të shkaktimit të aksidentit, nuk ka dhënë sqarime nëse automjeti ka pasur gomat e dimrit apo të verës dhe konstatimin e ekspertit që nuk ka qenë e nevojshme vendosja e zingjirëve.

Propozon refuzimin e kërkesëpadisë si të pabazuar, me arsyetimin se nga provat e administruara, veçanërisht nga takografët, raporti i punimeve ditore të autostradës dhe ditarin ndërtime i nënshkruar është vërtetuar se pala e paditur nuk është fajtores për shkaktimin e aksidentit e gjithashtu sqarojnë që ashtu siç është deklaruar eksperti i komunikacionit që paditësi nuk e ka përshtatur vozitjen me kushtet e komunikacionet për çka ka ardhur deri të aksidenti.

Nuk i kërkojnë në mënyrë të specifikuar shpenzimet e procedurës.

Për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata ka administruar provat dhe atë: me shikim në Raportin e Aksidentit nr. 2015-TR-0019 datë 12.01.2015; me shikim në certifikatën e regjistrimit të Automjetit nr. CRA0463598 për automjetin me targa 04-730-EJ; me shikim në Foto Dokumentacion; me shikim në Procesverbal mbi Dëmtimin e Automjeteve datë 22.01.2015; Procesverbal mbi Kalkulimin e dëmit për autiomjetin Renault Laguna datë 04.02.2015; me dëgjimin e dëshmitarit F.T. zyrtar pranë Ministrisë së Infrastrukturës; me dëgjimin e dëshmitarit Sh.K. si dhe me shikim në Ekspertizë mbi Dëmet e Shkaktuara në Komunikacion të ekspertit I.G. datë 03.05.2016 si dhe me shikim në ekspertizën e ekspertit të komunikacionit Y.K. 10.03.2022.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura në kuptim të nenit 8 të Ligjit Për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha atë së bashku dhe ka gjetur se:

Kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Me shikimin në Raportin e Aksidentit nr. 2015-TR-0019 datë 12.01.2015 gjykata ka vërtetuar se ka ndodhur aksidenti i komunikacionit në automjetin Reno Laguna me targa shakaktar për këtë aksident ka qenë bora e papastruar në atë pjesë të rrugës. Këtij rapoti gjyka i kushtoi besimin pasi që i njejtë është shoqëruar edhe me foto dokumentacion dhe i njejtë është përpiluar nga policia e trafikut në vendin e aksidentit.

Nga certifikata e regjistrimit të Automjetit nr. CRA0463598 për automjetin me targa 04-730-EJ, vërtetohet se automjeti i aksdientuar ka qenë i regjistruar në emër të paditësit I.K.

Nga Foto Dokumentacioni vërtetohet se në pjesën në të cilën ka ndodhur aksidenti ka pasur sasi të borës të papastruar.

Nga Procesverbali mbi Dëmtimin e Automjeteve datë 22.01.2015 vërtetohet shaklla e dëmit të shkaktuar në atomjetin e tipit Renault laguna me tabela të regjistrimit në pjesët e automjetit.

Nga dëgjimin i dëshmitarit F.T. zyrtar pranë Ministrisë së Infrastrukturës gjykata ka vërtetuar se kompania në atë pjesë të rrugës duke e ballafaquar edhe me fotodokumentacionin i cili ndodhet në shkresat e lëndës, nuk e ka mirmbajtur autostradën sipas kushte që janë të përcaktuara, pasi që i njejtë ka sqaruar se çdo herë kur ka trashësi të borës mbi 5 cm, kompania është e detyruar të bënë pastrimin e borës. Këtij dëshmitari gjykata i kushtoi besimin e plotë, pasi që i njejtë është zyrtar përgjegjës për këtë.

Nga dëgjimi i dëshmitarit Sh.K. gjykata nuk ka mundur të vërteton pretendimin e palës së paditur se rruga ka qenë e pastruar. Kësaj dëshmie gjykata nuk i kushtoi besimin e plotë. Së pari dëshmitari nuk ka qenë prezent në vend pas aksidentit, ashtu që dëshmia e tij nuk përputhet nga fotodokumentacioni i cioli ndodhet në shkresat e lëndës. Faktin se rruga ka qenë e pastruar e bazon në ditarin ndërtimore, raportin ditor dhe tahografët e levizjes së kamionit të cilat ndodhen tek pala e paditur.

Nga Ekspertizë mbi Dëmet e Shkaktuara në Komunikacion të ekspertit I.G. datë 03.05.2016, gjykata ka vërtetuar se dëmi i shkaktuar në automjetin e tipit Reno Laguna me targa i cili është objekt i këtij konteskti, është 2.220,42 €.

Nga akertiza e ekspertit të komunikacionit gjykata Y.K. është vërtetuar që shakaktar kryesor i aksidentit ka qenë faktori rrugë, gjegjësisht mirëmbajtja jo e duhur e rrugës nga organi kompetent, në atë mënyrë që ka pasur lëshime në pastrimin e shiritit të rrugës ndërmjet vendit ku autoudha ka dalje në vendin ku bëhet kyqja në autoudhë nga Suhareka, në të cilën pjesë vetura e tipit Renault ka humbur kontrollin pasi që ka rrëshqitur dhe është pprplasur mbrojtësit metalik.

Gjithashtu nga kjo eskertiz është vërtetuar që pjesërisht edhe ngasësi i automjetit ka kontribuar në askidentin e komunikacionit pasi që ka qenë në lëvizje prej 60 kmh derinë 80 kmh,

që në rast se do të zhvillonte shpejtësinë deri në 50 kmh nuk do të vinte te aksidenti, pavarësisht se shpejtësia e levizjes në at pjesë të autistradës ka qenë 120 kmh. Pra nuk vozitjen nuk e ka përshtatur me kushtet e rrugës.

Në kuptim të nenit 168 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Organizatat që ushtrojnë veprimtari me interes publik përgjigjen për dëmin nëse pa shkak kryejn jo më rregull shërbimin. Në rastin konkretë, nga palët nuk ka qenë kontestuese fakti që Kompania "F.C.", me seli në Komuna e Suharekës ka kryer shërbimin e mirëmbajtjes së rrugës në një pjesë të autostradës, në të cilën edhe është shkaktuar dëmi. Të drejtën e kryerjes së këtyre shërbimeve e ka marr nga Ministria e Infrastrukturës dhe ka qenë e detyruar në mirëmbajtjen e asaj pjese të autostradës. Mbi këtë bazë gjykata ka gjetur që pala a paditurë është fajtores kryesore për dëmin e shkaktuar në atë aksident.

Nga foto dokumentacioni si dhe nga deklarimi i dëshmitarit të F.T. zyrtar pranë Ministrisë së Infrastrukturës, gjykata ka vërtetuar se ajo pjesë e autostradës ka qenë e pa pastruar nga bora. Ndërsa vetë zyrtari i ministris, ka sqaruar se në rast se trashësia e borës kalon 5 cm, kompania e cila ka qenë e kontraktuar është dashur të del dhe të pastron autostradën, që në rastin konkret nga fotodokumentacioni shihet se trashësia e borës ka qenë më tepër se e lejuar.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e palës së paditur nëse vozitësi ka qenë ose jo nën ndikim të aloolit, apo nëse vozitjes nuk i ka përshtatur kushteve dhe rethanave në të cilat është ndodhur rruga. Ashtu që pretendimet e palës së paditur për gjykatën kanë qenë të pabazuara, pasi që në kohën kur ka ndodhur aksidenti ka qenë mengjes dhe pala paditëse së bashku me dy bashkëudhëtar kanë qenë duke shkuar në punë. Policia në raportin e aksidentit në rubriken për përqindjen e akloolit ka shënuar se nuk ka gjetur % të alkoolit. Pas daljes në vend vetë policia duke vërejtur kushtet në të cilat ka qenë rruga ka konstatuar se dyshohet se aksidenti ka ardhur si pasojë e mosmirëmbajtjes dhe mospastrimit të borës.

Në rast se në atë pjesë bora do të ishte pastruar dhe rruga nuk do të kishte atë sasi të borës, policia në raportin e aksidentit nuk do të kishte konstatuar ashtu siç e ka konstatuar.

Gjykata ka vlerësuar kundërshtimet e palës së paditur sa i përket përgjegjësisë së palës së paditru me arsyetimin që ekspertit nuk ka sqaruar sakt kohën e aksidentit, faktin nëse pala paditëse në automjetin e vet i ka pasur të vendosura gomat e dimrit apo të verës dhe faktin që pala paditëse nuk i ka pasur të vendosura zingjrrët. Mirëpo ka gjetur që këto pretendime janë të pabazuara. Pasi që pavarësisht se koha e shkaktimit të aksidentit nuk është paraqitur, nuk mund të qendron pretendimi i palës së paditur që në ndërkohë deri sa policia mka ardhur në vendin e ngjarjes të ketë rënë borë dhe e ka mbuluar rrugën. E gjithë kjo që në pjesën e rrugës në të cilën është shkaktuar aksidenti rruga pjesërisht ka qenë e mbuluar me borë, jo në tërësinë e sajë sikurse të kishte reshur borë.

Gjithashtu nuk qendron edhe pretendimi që ekspertit nuk ka sqaruar nëse gomat kanë qenë të verës apo të dimrit, i cili fakt do të ndryshonte edhe konstatimin se kush ka qenë fajtor në aksident, pasi që nëse pala paditëse në veturën e sajë do të kishte goma të verës, nga ana e policisë do të ishte shqiptuar dënim për kundërvajtje, gjë që në rastin konkretë në procesverbalinë e vendit të ngjarjes ai fakt nuk paraqitet pasi që për gjykatën është e besueshme se automjeti ka pasur gomat e dimrit, prkatësisht pneumatikët në madhësinë e lejuar.

Sa i përket vendosjes së zingjirëve gjykata raportit të ekspertit i kushtoon besimin e plotë pasi që në pjesët tjera të rrugës ruga ka qenë e pastruar nga dëbora dhe nuk ka qenë e nevojshme vemndosja e zingjirëve.

Lidhur me shumën të cilën gjykata e ka miratuar, ka pasur për bazë edhe të gjeturat e ekspertit të komunikacionit, që pjesërisht pala paditëse ka kontribuar në shkaktimin e aksidentit nga fakti që shpejtësia e levizjes ka qenë në mes 60 deri 80 kmh, ku nëse do të ishte deri në 50 kmh nuk do të kishte ardhur deri të aksidenti.

Shumës të cilën gjykata e ka refuzuar dhe atë duke minusuar shumën 220,40 € nga shuma e tërsishme 2.220,40 € e përcaktuar nga eksperti vlerësues i dëmëve në automjet, ka pasur për bazë pikërisht kontributin e palës paditëse në shkaktimin e skidentit. Gjykata me shumë kujdes ka vlerësuar të gjeturat e ekspertit sa i përket mospërshtatjes së vozitjes kushteve dhe rrethanave të rrugës. Mirëpo ka konstatuar që ndryshimi i shpejtësisë në mes 50 kmh dhe 60 apo 80 kmh është thujse i papërfillshëm në konstatimin që vozitjes nuk i ka përshtatur kushteve dhe rrethanave të rrugës, gjithnjë duke pasur poarasys shpejtësinë e lejuar në autostradë dhe gjendjen e rrugës deri sa paditësi është ballafaquar më pjesën në të cilën rruga nuk ka qenë sa duhet e pastruar.

Gjykata ka refuzuar pjesën e kërkespadi së mbi pjesën e miratuar, pasi që nga llogaritja e ekspertit të dëmit në automjetin e dëmtuar, shuma prej 2.446,00 € është shuma nëse ndërrohen të gjitha pjesët e dëmtuara së bashku me punën e dorës. Ndërsa shuma 2.220,42 €, është vlera e automjetit nese blehet në treg. Kështu që për gjykatën vlera përfundimtare e paraqitur nga eksperti u morr për bazë kur vendosi lidhur me shumën e dëmit që duhet t'i paguhet palës paditëse, me përjashtim të zbritjes që bëri gjykata në emër të kontributit të paditësit në shkaktimin e aksidentit ashtu siç ka vendosur në dispozitiv, ku shumë e përgjithshme për kompensim do të jetë shuma 2.000,00 €.

Gjykata në kuptim të nenit 452 par. 1 lidhur me nenin 463 të Ligjit për Procedurën Konrtestimore vendios që pala e paditur t'i paguan shpenzimet e procedurës, dhe atë 104,00, për përpilimin e padisë, 405,00 € për 3 përfaqësimin e palës paditëse nga avokati në seanca, për lëndën C. Nr. 129/15, e cila është prishur dhe kthyer në rigjykim, 936,00 € për përfaqësim në 9 seanca gjat procedurës në rigjykim, 100,00 € për ekspertizën e punuar nga eksperti vlerësues në automjet, 150,00 € për emskertizën e ekspertit të komunikacionit, si dhe 21,00 € për taksa për padinë, gjithësejt 1.974,00 €, pasi që pala e paditur e ka humbur çështjen ndërsa pala paditëse në mënyrë të specifikuar i ka kërkuar shpenzimet, të cilat shpenzime janë në përputhje me tarifën e odes së avokatëve. Për seancën e datës 06 maj 2016 gjakata nuk ka pranuar shpenzimet e pçalës paditëse pasi që ajo seancë është shtyrë me kërkesën e të autorizuarit të paditësit.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C. nr. 1049/2020, datë 30.01.2024

Gj y q t a r i
Atdhe Berisha

Numri i lëndës: 2020:101163
Datë: 22.03.2024
Numri i dokumentit: 05489268

UDHËZIME PËR ANKESË: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, në Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.